Numër: 01/401
Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** "New Born Master" SH.P.K. Qendra Për Aftësim Profesional, me adresë Rruga "Xhavit Sylaj" 23000, Suharekë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2021 deri 19.08.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Muratorë dhe punëtorë të ngjashëm, niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D), me 16 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga 16 kandidat për pjesën teorike, ndërsa për pjesën praktike me nga 8 kandidat për grup. Institucioni mund të ofroj, vlerësoj dhe certifikoj brenda këtij kualifikimi vetëm këto module:

   - **1.1.1** Hyrje ne ndërtimtari, planifikimi dhe organizimi i punës me 2 kredi;
   - **1.1.2** Siguria, shëndeti në punë dhe mbrojtja e ambientit me 2 kredi;
   - **1.1.3** Leximi i projekteve dhe matjet teknike me 3 kredi;
   - **1.1.4** Muratimi i mureve me tulla dhe blloqe me 6 kredi;
   - **1.1.5** Muratimi i mureve ndarëse nga rigipsi me 3 kredi.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "New Born Master", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. New Born Master, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK